

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Mbledhja e Këshillit të Sigurisë, Bamir Topi komenton arrestimin e kreut të SHISH: Kur ndodhi Gërdeci, u në zgjodha...
ADRESA	https://www.gazetatema.net/politika/mbledhja-e-keshillit-te-sigurise-bamir-topi-komenton-arrestimin-e-kreut-i588966
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	28 shtator 2026, 13:34:15 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	28 shtator 2026, 13:30:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	52bcabeb2e09134f6e08f7797816ab4d7b5f6bf6131c7705aae349919ddb32cb
TEKSTI	858aa7a1b8ec365645fd384b61c87a84baaad75c744fa6bf80fc7b1031a07820
PAMJA	43c32a1035ff886504d66fccb53d100921a336b77fca6007cd067705eb77251a

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	568d4f33b901afc009e670eefed0b0327e3ad431c1d7a98226a790b46f2e0383
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	282274d0ff18f09ea4854e79728659ffe2d6cd028bfa2085cb95da6ce0a699bb
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/568d4f33b901afc009e670eefed0b0327e3ad431c1d7a98226a790b46f2e0383>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)
- [Hosteni](#)

English

Built and Monetized by



English



ie [Syjvester Stallone rrefen betejën me fizikun: "U bera bulimik dhe perdora steroide per Rocky III"](#) [Mbledhja e Keshillit te Sigurise, Bamir Topi komenton arrestimin e Kreut fundit](#)

Mbledhja e Këshillit të Sigurisë, Bamir Topi komenton arrestimin e kreut të SHISH: Kur ndodhi Gërdeci, unë zgjodha...



28 Shtator 2026, 15:30Politika TEMA



Ish-presidenti Bamir Topi ka komentuar zhvillimet e fundit në vend, duke u ndalur te situata e krijuar rreth Shërbimit Informativ të Shtetit dhe mbledhja e Këshillit të Sigurisë Kombëtare. Ai e cilësoi çështjen e SHISH si një ngjarje me peshë të veçantë për shtetin shqiptar, duke theksuar se pasojat e saj lidhen edhe me marrëdhëniet me partnerët ndërkombëtarë. Sipas ish-presidentit, Këshilli i Sigurisë Kombëtare nuk është një strukturë që mbledhet në mënyrë të shpeshtë, por thirret nga Presidenti në raste kur zhvillimet kanë një rëndësi të veçantë.

"Këshilli i Sigurisë Kombëtare, në një farë mënyre konsiderohet si këshill në ndihmë të presidentit. Thirret nga presidenti dhe ai nuk mbledhet në mënyrë shumë frekvente, por në ngjarje të rëndësishme", -tha në "News 24". Topi sqaroi se fakti që Këshilli nuk mbledhet për çdo zhvillim nuk do thotë se komunikimi institucional ndërpritet. Sipas tij, mbledhja e tij tregon se një çështje ka marrë një përmasë të rëndësishme publike dhe shtetërore.

Topi vuri theksin te marrëdhëniet me partnerët ndërkombëtarë dhe te rëndësia e besueshmërisë së institucioneve shqiptare, veçanërisht në kushtet kur Shqipëria është anëtare e NATO-s. "Ne jemi vend anëtar i NATO-s. Ti mban komunikim të vazhdueshëm me partnerët. Edhe në rast se nuk ka gjë konkrete, nuk kam informacion konkret, por tek e fundit, fillon dhe bie rëndësia e kredibilitetit e partnerëve ndaj teje".

Duke folur për mënyrën sesi zhvillohet një mbledhje e Këshillit të Sigurisë Kombëtare, Bamir Topi theksoi se diskutimet zhvillohen me dyer të mbyllura dhe se mënyra e komunikimit me publikun mbetet në diskrecionin e Presidentit. Ai solli në vëmendje edhe një precedent nga koha kur ishte në krye të Presidencës, duke iu referuar tragjedisë së Gërdecit. "Unë kam pasur një rast kur ndodhi ngjarja e Gërdecit, ku u mblodh Këshilli rreth një javë pas ngjarjes. Unë zgjodha t'i drejtohem publikut me një apel publik, dhe më pas punimet u zhvilluan me dyer të mbyllura". Në fund, Topi nënvizoi rëndësinë e debatit institucional gjatë mbledhjeve të Këshillit të Sigurisë, duke argumentuar se prania e drejtuesve kryesorë të shtetit krijon mundësinë për një analizë të gjerë të situatës.



Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Tabaku: Hetimi i zyrtarëve të lartë nuk është certifikatë pastërtie për qeverinë](#)

14:08 Politika / 8 komente

Anëtarësimi në BE - Ministri Hoxha: Shqipëria nuk kërkon rrugë të shkurtra, angazhimi ynë me reformat është i palëkundur

13:50 Politika

[Balla u drejtohet europarlamentarëve në Tiranë: Vëreni në krye të agjendës ratifikimin e aderimit të Shqipërisë në BE](#)

13:30 Politika

[Rama mbledh ministrat dhe drejtuesit e qarqeve në "Vilën e Kuqe"](#)

13:20 Politika / 1 koment



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.